




Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Skupština Opštine štrpce
Kuvendi i Komunes se Shtërpcës
Municipality of Strpce



Në mbështetje të nenit 12, 17, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpcës 01-Nr 898 të datës 14/07/2010, si dhe dispozitave të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale Kuvendi i Komunës së Shtërpcës në mbledhjen e mbajtur më datën 24.09.2010 miratoi këtë :

V E N D I M

MBI PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE

I

Me këtë plotësohet dhe ndryshohet Rregullorja për Taksa, Tarifa dhe Gjoha komunale 01-Nr-713 e datës 01.06.2010 dhe atë neni 3.9 ku shtohet nr. Rendore 16 për taksat e poshtëshënuara me tekstin siç vijon:

3.9. Taksat për produktet pyjore .

3.9.1. Me “Produkte pyjore” nënkuptohen të gjitha produktet natyrore të pyjeve dhe tokave pyjore duke përfshirë produktet drunore dhe produktet jodrunore.

3.9.2. Taksat për produktet pyjore sekondare (mbeturinat drunore) do të jene 8 € për m³

3.9.3. Taksat për produktet natyrore të pyjeve (produktet drunore dhe produktet jodrunore) të cilat nuk janë të ndaluara me ligj janë siç vijon:

- a) Ditore 1 €
- b) Javore 5 €
- c) Mujore 15 €
- d) Për grumbulluesit e regjistruar të produkteve pyjore taksa është në nivel sezonal në vlerë prej 500 € për rezonë.

3.9.4. Nga taksat e lartëshenuara ne pikën 3.9.3 (a, b dhe c) lirohen qytetarët të cilët këto produkte i shfrytëzojnë për nevoja familjare e jo për nevoja komerciale.

3.9.5. Për mosrespektim të pagesës së taksave të caktuara, organi kompetent do të ndërmer masa konform ligjeve në fuqi.

II

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Turizëm, Bujqësi dhe Pylltari

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit Komunal

KUVENDI I KOMUNËS - SH TË R P CË

01-Nr- 1144

Më datë 29.09.2010

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Dejan Mrdjinac

